

Ndërprerja e Kontratës

Kontrata e furnizimit mund të ndërpritet vetëm në rastet si më poshtë:

- Me kërkesë të Klientit, pas ekzekutimit të të gjitha detyrimeve monetare,
- Me iniciativën e Furnizuesit,
- Nëse Klienti nuk paguan detyrimet e energjisë elektrike brenda 1 muaji pas ndërprerjes së energjisë elektrike.
- Nëse Klienti merr energji elektrike në mënyrë te paligjshme.
- Nëse Klienti, në mënyrë të përsëritur, nuk i krijon akses Furnizuesit për më shumë se 3 muaj për leximin e verifikimin e matësave dhe instalimeve, brenda kufijve të pronës të tij.
- Nëse klienti , nuk merr masa për zbatimin e kushteve te kontrates

Procedura e perfundimit te kontrates

- Klienti njofton me shkrim Furnizuesin 15 ditë kalendrike përpara,
- Likuidon të gjitha detyrimet përkundrejt Furnizuesit jo më vonë se 30 ditë nga mbyllja apo pezullim
- Klienti merr konfirmim për arkëtimin e tarifës së ndërprerjes së kontratës
- Klienti nuk është përgjegjës për asnjë detyrim që mund të rezultojë ndaj Furnizuesit pas përfundimit të afatit 30 ditor pas depozitimit të kërkesës dhe shlyerjes të gjitha detyrimeve financiare).
- Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, Furnizuesi do të ndërpresë menjëherë furnizimin e energjisë elektrike në pikën e lidhjes, nëpërmjet operatorit të shpërndarjes
- Me ndërprerjen e lidhjes, Furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vuloset pika e lidhjes, duke u përdorur një vulë të ndryshme nga ajo e lidhjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.